

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Pyetja që më është drejtuar, lidhet me një informacion më të plotë për partneritetin midis universiteteve publike shqiptare dhe universiteteve prestigjioze europiane apo ndërkombëtare. Më lejoni të them qysh në fillim se, në krahasim me reformat e suksesshme të deritanishme në sistemin parauniversitar, ne jemi të ndërgjegjshëm që reforma e realizuar para 6 vjetësh në arsimin e lartë nuk na i ka dhënë akoma të gjitha rezultatet që pritëshin. Për këtë arsye ne nuk e mohojmë dot se ka shumë studentë shqiptarë, të rinj dhe të reja, që, pasi mbarojnë shkollën e mesme, detyrohen të shkojnë në universitetet më të mira europiane apo edhe më larg për të marrë shërbimin më të mirë, për të marrë cilësinë më të lartë të universiteteve. Pikërisht për këtë arsye ne kemi vendosur që një nga mekanizmat, që do të përdorim për të rritur cilësinë në arsimin e lartë, të jetë bashkëpunimi i ngushtë me universitetet më prestigjioze ndërkombëtare. Kemi filluar deri tani iniciativa konkrete. Unë mund t'ju përmend disa prej tyre. Kemi zhvilluar takime me përfaqësues me drejtuesit më të lartë të Universitetit BOKU në Vjenë, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës për të realizuar, për të hartuar programe studimi të përbashkëta apo programe të dyfishta. Po kështu, iniciativa të ngjashme kemi nisur edhe me universitete të ndryshme italiane, kryesisht në rajonin e Pulias, për të mundësuar një partneritet konkret me universitetin e Vlorës. Po kështu, me universitetin e Janinës dhe universitetin e Gjirokastrës. Pra, jemi duke punuar intensivisht në bashkëpunim me universitetet publike shqiptare për të krijuar pikërisht këto partneritete, këto bashkëpunime, ashtu sikurse ne do të nxisim dhe do të mbështesim edhe hapjen e filialeve të universiteteve më të mira këtu në Shqipëri.

Rasti më konkret, për të cilin ne po punojmë dhe shpresojmë shumë shpejt të kemi rezultat, është Universiteti Teknik i Stambollit, që të gjithë e dimë se është një nga universitetet më të mira të rankuara në top-listën e universiteteve botërore. Dua të theksoj, gjithashtu, se bashkëpunimet nuk do të jenë vetëm në kuadër të programeve të studimit, të përbashkëta apo të dyfishta, por bashkëpunimi do të shtrihet në të gjitha aspektet e jetës universitare dhe akademike me projekte të përbashkëta, me shkëmbime pedagogësh, studentësh, me lidhjen me tregun e punës e kështu me radhë. Në fund fare, për të mos u zgjatur, sepse detaje të tjera mund të jap edhe gjatë fjalës sime pak më vonë, dua të theksoj edhe ngritjen e bordit të ri të akreditimit në Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në të cilin kemi përfshirë profesorë të nderuar, shqiptarë e të huaj, që punojnë në universitetet më të mira europiane, por edhe amerikane. Janë që të gjithë profesionistë shumë të mirë, akademikë shumë të mirë, njerëz me integritet, që ne besojmë se do të japin kontribut jo vetëm për rritjen e cilësisë në lidhje me akreditimin e universiteteve, po edhe për të krijuar ura bashkëpunimi me universitetet që ata përfaqësojnë, me universitetet ku ata punojnë. Kështu, ne jemi të vendosur që, shumë shpejt, në arsimin e lartë të kemi akoma më shumë rezultate për reformat. Faleminderit!

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI- Pjesa e dytë

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur bëhet fjalë për arsimin, të gjithë ekspertët dhe politikëbërësit bien dakord që sa më të mëdha e të thella të jenë politikat dhe reformat, aq më shumë kohë kërkojnë për t'u zbatuar dhe për t'u vlerësuar. Madje, shpeshherë gjatë zbatimit ato influencohen shumë edhe nga ndryshimet dhe dinamikat që ndodhin në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, çka e bën edhe më të vështirë matjen e rezultateve. Megjithatë, është po aq e vërtetë që jo vetëm reformat e mëdha, por edhe ndryshime të vogla, madje sado të vogla qofshin, mund të ndikojnë ndjeshëm në jetën e njerëzve dhe të shumë familjeve. Prandaj, përgjegjësia jonë në arsim ndaj të gjithë shoqërisë, është e jashtëzakonshme, duke filluar që nga Kryeministri, unë dhe drejtuesit më të lartë të institucioneve arsimore e deri te mësuesit më të thjeshtë që punojnë me përkushtimin më të lartë në çdo skaj të vendit, duke përfshirë edhe zonat më të largëta.

Reformat e ndërmarra në arsim vitet e fundit, tashmë, kanë filluar t'i japin rezultatet pozitive vit pas viti dhe janë të prekshme e të matshme. Kjo na bën të besojmë se jemi në rrugën e duhur dhe mbi baza të shëndosha, ndërkohë jemi plotësisht të ndërgjegjshëm që kemi ende shumë punë për të bërë, në përbushje të synimit tonë kryesor për një sistem arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë, i cili krijon kushte që të gjithë nxënësit pa asnjë dallim të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, si dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së tyre e të gjithë shoqërisë. Kështu, në vazhdim të reformave të deritanishme në arsimin parauniversitar dhe në përshtatje me nevojat dhe dinamikat e reja të shoqërisë dhe tregut të punës, një nga risitë tona, që do të fillojë menjëherë që këtë vit shkollor, është mësimi i gjuhës angleze, si lëndë e detyruar që nga klasa e parë e arsimit bazë, për të cilën, tashmë, janë hartuar të gjitha programet e tekstet mësimore dhe do të vijohet me trajnimin e mësuesve në të gjithë vendin.

Gjithashtu, ne kemi identifikuar edhe edukimin për artet dhe zëjet në shkollë, si një instrument efikas për zhvillimin të nxënësit të vlerave që lidhen me traditën dhe komunitetin. Ky edukim përfshin krijimtarinë, novacionin dhe marrjen përsipër të iniciativave apo të projekteve që zhvillohen në bashkëpunim dhe në partneritet me prindërit, me komunitetin dhe me bizneset lokale që zhvillojnë zeje të ndryshme. Menjëherë, që në fillim të këtij viti shkollor, do të rritet edhe numri i klasave të profilizuara sportive në të gjithë vendin, duke shtuar disiplina të reja sportive, duke vazhduar investimet, si dhe duke identifikuar dhe duke mbështetur talentet e reja. Objektivi ynë është që vitin e ardhshëm edhe zhvillimi i kompetencës digjitale të nxënësve të fillojë që në klasën e parë, me qëllim që ata të jenë të suksesshëm në jetën personale, shoqërore dhe profesionale, si dhe të aftë për të përballuar kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Gjithëpërfshirja është politika jonë bazë në arsim. Prandaj, në fokusin e punës tonë, pa dyshim, do të jetë edhe përmirësimi i shërbimit për nxënësit me aftësi ndryshe; do të vijojmë me rritjen e numrit të mësuesve ndihmës, duke synuar raportin një mësues ndihmës për 2-3 nxënës me aftësi ndryshe dhe do të vazhdojmë më trajnimin e tyre për të garantuar një shërbim më cilësor, si dhe për të nxitur edhe më shumë integrimin e nxënësve më aftësi ndryshe në shkollë së bashku edhe me përmirësimin e shërbimit psiko-social në shkollat tona. Falë investimeve në infrastrukturën shkollore në të gjithë vendin dhe me programin e madh të rindërtimit pas tërmetit, ky mandat do të shënojë fundin e shkollave me dy turne. Shkollat e reja do të jenë më të mëdha, më të forta, më të sigurta, më të bukura dhe sipas standardeve më të mira

bashkëkohore. Në çdo kohë mësuesit meritojnë vlerësimin dhe vëmendjen tonë maksimale, sidomos pas sakrificës së tyre të jashtëzakonshme në një periudhë ndër më të vështirat dhe më sfiduese të njerëzimit, siç ishte pandemia, ne do të vazhdojmë të vlerësojmë dhe të rritim akoma më shumë dinjitetin tashmë të rikthyer të mësuesve nëpërmjet rritjes së mëtejshme të pagës, në fakt, rritja më e madhe ndonjëherë, 40% brenda një mandati. Kjo bashkë me respektin dhe mirënjohjen tonë të thellë që nuk mund të përkthehet dot asnjëherë në vlerë monetare. Të nderuar deputetë, Në këtë mandat të ri sistemi ynë arsimor do të hyjë në një fazë të re zhvillimi. Në fokus të tij do të jetë sidomos arsimi i lartë, duke synuar një sistem gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik dhe transparencës, si dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Siç e theksova sot në fjalën time të parë, një nga mekanizmat që do të përdorim për rritjen e cilësisë në arsimin e lartë është ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi i ngushtë i universiteteve shqiptare me universitetet më prestigjioze ndërkombëtare. Ne do të nxitim dhe do të mbështesim hapjen e filialeve të këtyre universiteteve në Shqipëri, si dhe çdo iniciativë për programe studimi të përbashkëta apo të dyfishta në gjuhën angleze. Së fundi, kemi vendosur ura të reja bashkëpunimi me rektorët e universiteteve dhe me Bordin e Ri të Akreditimit, pikërisht për të garantuar hapat që qeveria nuk mund t'i bëjë dot e vetme, por vetëm duke qenë të gjithë bashkë, në funksion të rritjes së cilësisë në arsimin e lartë.

Për sa u përket kërkimit shkencor dhe inovacionit, ligji në fuqi për shkencën nuk u përgjigjet zhvillimeve dhe kërkesave të kohës. Për këtë arsye ne do të fillojmë brenda vitit të parë të mandatit punën për draftimin e projektligjit të ri për shkencën, paralelisht edhe me hartimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor 2023-2028. Së fundi, nuk mund të lë pa përmendur një pjesë të rëndësishme të punës sonë, e cila lidhet me sportin, ku ne synojmë krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin sistematik të edukimit fizik dhe të sportit nga të gjitha moshat. Në mënyrë të veçantë ne po punojmë që sportistët elitarë të motivohen dhe t'u krijojnë të gjitha mundësitë për të arritur rezultate të larta në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u ofruar atyre të gjithë mbështetjen e nevojshme dhe jo vetëm atë financiare. Gjithashtu, nisur nga objektivi ynë për masivizimin e sportit dhe rritjen e vlerave sportive, ne do të rritim numrin e aktiviteteve sportive në sistemin parauniversitar dhe arsimin e lartë, do të organizojmë kampionatin kombëtar të shkollave në të gjitha disiplinat sportive, si dhe do të organizojmë ekipet përfaqësuese në veprimtaritë ndërkombëtare të sportit shkollor dhe atij universitar. Të nderuar kolegë, Koha në dispozicion është e kufizuar dhe e kam të pamundur t'i rendis të gjitha angazhimet dhe prioritetet tona në arsim, por në fund dua të theksoj që, sidomos sot, më shumë se kurrë, për të zhvilluar një shoqëri të shëndetshme dhe solidare na nevojiten profesionistë të aftë dhe qytetarë të denjë, çka mund t'i garantojë vetëm një sistem arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës. Prandaj arsimi duhet dhe do të jetë gjithmonë një nga prioritetet tona kryesore që nxit njëkohësisht edhe zhvillimin e ekonomik e social të vendit, mbi të gjitha, e kemi detyrim ndaj fëmijëve tanë, ndaj brezit të ri dhe Shqipërisë sonë për një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt. Faleminderit!